

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J

Nr.9973, datë 28.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8025,
DATË 9.11.1995 “PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JONIZUESE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Ky ligj përcakton kushtet e mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar, në maksimum, të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese.”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Subjekt i këtij ligji është çdo person fizik ose juridik, i cili:

- a) zotëron, riparon, mirëmban, transferon, merr, përdor, fabrikon ose instalon pajisje rrezatuese, të cilat transmetojnë rrezatime jonizuese dhe përmbajnë komponentë, që veprojnë me një diferencë potenciale më shumë se 5 kV;
- b) kryen kërkime radiologjike, punime minerare, prodhim, bluarje, ekstraktim, pasurim, shitje, transferim, import-eksport, dhënie me qira dhe ruajtje të lëndëve radioaktive;
- c) trajton, prodhon, manovron, përdor dhe ruan mbetje radioaktive, ushqime dhe produkte të tjera, të ndotura me lëndë radioaktive;
- ç) kontrollon, nga ana teknike dhe funksionale, aparaturat, burime të rrezatimit jonizues.”.

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Personat fizikë ose juridikë, të pajisur me licencë, kanë përgjegjësi ligjore për mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin nga burimet e rrezatimit jonizues, si dhe për zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë ligj e në akte të tjera, të dala në zbatim të tij. Personat fizikë ose juridikë, përdorues të burimeve të rrezatimit jonizues, janë të detyruar të kalojnë në proces kontrolli teknik aparaturat, burimet e rrezatimit jonizues, sipas kriterëve të parashikuara në rregulloren përkatëse.”.

Neni 4

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

1. Pranë Ministrisë së Shëndetësisë krijohet Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, si autoriteti përgjegjës kombëtar rregullator, i cili mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.
2. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet kryesohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe përbëhet nga 7 anëtarë.
3. Në varësi të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet ngrihet zyra e mbrojtjes nga rrezatimet, si njësi ekzekutive. Kryetari i kësaj zyre është dhe sekretar i komisionit.
4. Përbërja, organizimi, funksionimi dhe mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

- a) Në shkronjën “a”, fjala “nxjerr” zëvendësohet me fjalën “harton”.
- b) Shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) bashkërendon punën me institucionet e specializuara, për kalibrimin e pajisjeve të rrezatimit jonizues, dozimetrinë personale, monitorimin e mjedisit, për kontrollin mjekësor të punonjësve të ekspozuar profesionalisht, trajnimin e personelit me ekspertë të pavarur për veprimtari me rrezatime jonizuese, si dhe me institucione të tjera, sipas nevojave, në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit për zgjidhjen e problemeve kombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi.”.

Neni 6

Në nenin 8, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) zyra për mbrojtjen nga rrezatimet mban inventarin kombëtar të burimeve të rrezatimit jonizues.”.

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

1. Rregulloret për mbrojtjen nga rrezatimet, për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues, të hartuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet miraton kodet e praktikave, udhëzimet dhe norma të tjera, të lidhura me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues.”.

Neni 8

Në nenin 10, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 4 e 5 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Jozefina Topalli (Çoba)